

DPK/DMP

02

03-1451/13

21.05.2013 Regj.nr.10117/12

GJYKATA THEMELORE NE GJILAN,Departamenti I pergjithshem-Divizioni I kundervajtjes,sipas Gjykatesit Veli Kryeziu,kunder te pandehurit **Avdyl Selmon Aliu nga Gjilani**,Rruga Mulla Idrizi p.n.per shkak te kundervajtjes nga neni 17 p.1.3,te Ligjit nr.04/L-50 te Ligjit per deklarim,Prejardhjen dhe kontrollin e pasurise te zyrtarve te lart public,e ne baze te nenit 73,74,195 dhe 9 te Ligjit mbi kundervajtjet,me date 29.04.2013 muar kete :

AKTVENDIM

I pandehuri **Avdyl Selmon Aliu nga Gjilani** I lindur me 02.03.1967 ne Gjilan,rruga Mulla Idrizi p.n.,shqiptar ,shtetas I Republikes se Kosoves,me profesion Ing.diplomuar,I martuar,I gjendjes se mesme ekonomike,kinse nuk eshte I denuar e as ne hetime

ËSHTË PERGJEGJËS

Sepse me date 03.07.2012 eshte konstatuar se i njeiti me kohe nuk e deklaruar formularin mbi deklarimin e pasurise si zyrtar I lart per deklarimin e pasurise,sepse si keshilltar I KK Gjilan,pas afatit ligjor e ka derguar te njejtin.

Me qka ka kryer veper kundervajtese nga neni 17.al.1.3,Per deklarimin,Prejardhjen dhe kontrollin e Pasurise dhe te zyrtarve te larte Publik.,dhe per ate shpallet pergjegjes dhe

DENOHET

ME DENIM ME GJOBË ne Shumen prej 700 (shtatqind euro),te cilen gjobe I pandehuri eshte I obliguar ta paguaj ne afate prej 15 ditesh nga dita e plotefuqishmerise se ketij Aktvendimi ne te kunderten,gjoba do te zavendsohet ne denim burgu ku nje dite burgu ka per tui llogaritur 20 euro. Obligohet I pandehuri qe ne emer te paushallit gjyqësor të paguaj prej 10 euro,ne afatin e njejtë si dënimi me gjobë.

Arsyetim

Agjensioni kundër kurupsionit me kerkesen e vetë nr.Z.D. 01-2357/12 te datës 18.07.2012 ka kerkuar qe kunder te pandehurit te zhvillohet procedura dhe të ndeshkohet sipas Ligjit. Gjykatësi i divizionit te kundervajtjes duke u bazuar ne Ligj,thirri te pandehurin i cili me date 22.04.2013 u deklarua ne lidhje me veperen kundervajtese e i cili ne deklaraten e vete nder të tjera ka theksuar: Është e vertet thënjët në kerkese por ketu kisha per të shtuar se nuk kam qen me kohë i njoftuar se duhet te bëhet fletëparaqitja se duhet të dërgohen shenimet ne agjensionin kunderkurupsionit,unë të dhënat i kam derguar por te njejtat i kam derguar me vonesë,e ndij veten fajtor dhe kerkoj nga gjykata të më shqiptoj në dënim sa ma te butë. Pasi që i pandehuri e ka pranuar ne tersi kundervajtjen e bërë,gjykatësi nuk pati nevoj të shtjelloj prova tjera,andej e shpallet pergjeggjës për veperen kundervajtëse dhe i shqipto nje denim sa ma të butë,si në

-2-

dispozitiv të këtij Aktvendimi dhe ate duke u bazuar ne nenin 17,p1,3 të Ligjit Per deklarimin,Prejardhjen dhe kontrollin e Pasurise dhe te zyrtarve te larte Publik.

Me rastin e matjes së së dënimit me gjobë,gjykata me kujdesë vleroi mbrojtjen e të pandehurit si dhe shkresat e lëndës duke u bazuar ne rethanat lehtësuese dhe renduese në lidhje me veprën kundërvajtëse në fjalë.Andej duke e zbatuar nenin 9 të LMK-së Gjykatësi zbuti jashtezakonisht denim e parapar ligjor ,duke mar parasysh se ky është denim I pare dhe se ne të ardhmen është deklaruar se nuk do të kryej veper tjeter të llojit të njejt,është punëtor arsimor,dhe se nuk do të përsrisë kundërvajtjen e tillë,kurse si rethan renduese u muar pasha e kundërvajtjes dhe I shqiptoi kete denim,I bindur se edhe me kete denim ka për tu arritë qëllimi I dënimit tek I pandehuri,Vendimi mbi paushallin gjyqësor u muar në bazë të nenit 109 par.1 të Ligjit mbi kundervajtjet,
Me sa u tha me lartë u vendosë sin ë dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DIV.KUNDËRVAJTJES
ME 24,04,2013**



Gjyqëtari
Veli KRYEZIU

UDHËZIMI MBI MJETIN JURIDIKË :Kundër këtij Aktvendimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë ,Divizionit për kundërvajtje,ankesa dorëzohet perms këtoj Divizioni.